

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"Operacion ndikimi"/ Nga lodrat e sek*it, tek mbathjet e sms dashurie, çfarë mbulon SPAK me "kronikën r ozë"
ADRESA	https://boldnews.al/2026/09/24/operacion-ndikimi-nga-lodrat-e-sekit-tek-mbathjet-e-sms-d-ashurie-cfare-mbulon-spak-me-kroniken-roze/
BURIMI	boldnews.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	24 shtator 2026, 10:32:43 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	24 shtator 2026, 10:27:47 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	e6133442cbb58fb845091f16e350ad895df228f3c5f154bd73caa5c4cb5d74b3
TEKSTI	39d3ed26b134fcb00b99aa07c882d380abe31f6a25e7e73bc6a187c47a645bc8
PAMJA	d9749199108a903fce547e46de7df54b326f4743767fc3c212dbccbbc8727125

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	cf3e733c8cc8cc36e062e61cfd14b6bca0c659db5245b65bada2f4628dfd3a14
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	34bf9fb855e0215b8384019a592b192cd8415b3fea3e8d3a2dd71c749e8b79fe
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/cf3e733c8cc8cc36e062e61cfd14b6bca0c659db5245b65bada2f4628dfd3a14>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Fillimi > AKTUALITET

“Operacion ndikimi”/ Nga lodrat e sek*it, tek mbathjet e sms dashurie, çfarë mbulon SPAK me “kronikën rozë”

12:27 : 24/09/2026 në AKTUALITET, KRONIKE, KRYESORE, POLITIKE



Nga Boldnews.al

Detajet e rrjedhura nga dosja hetimore e Vlora Hysenit e paraqesin shafen e shkarkuar të Shërbimit Sekret si një zonjë, që dashuria ndaj personit në kërkim, Ergys Agasi, e çoi drejt kryerjes së veprave penale.

Prokuroria e Posaçme (SPAK) dyshon se zonja Hyseni ka kryer dy vepra penale: “përkrahje e autorit të krimit” dhe “zbulimi i akteve ose të dhënave sekrete”.

Nga narrativa e sugjeruar deri më tani nga prokuroria, nëpërmjet kanaleve mediatike, krijohet idea se këto dy vepra penale lidhen me të njëjtin fakt-ajo ka ndihmuar Agasin t'i shmangët zbatimit të urdhër-arrestit të lëshuar nga Gjykata e Posaçme, si edhe i ka dhënë atij informacione nga strukturat e tjera shtetërore për t'iu shmangur operacioneve (të mundshme) për arrestimin e tij.

Lexo edhe:

[VIDEO/ Vlorë Hyseni shantazhon publikisht gazetaren Klodiana Lala](#)
[Pritet t'i komunikohet masa, Vlorë Hyseni mbërrin në GJKKO](#)

TË GJITHA



VIDEO/ Vlorë Hyseni shantazhon publikisht gazetaren Klodiana Lala

12:31 : 24/09/2026



“Operacion ndikimi”/ Nga lodrat e sek*it, tek mbathjet e sms dashurie, çfarë mbulon SPAK me “kronikën rozë”

12:27 : 24/09/2026



“Vlorë Hyseni ju fiku radarët e shtetit”/ Bardhi: Ia keni dorëzuar me vetëdije shtetin gupeve kriminale!

12:15 : 24/09/2026



Berisha-ministres Ismaili: A keni kaluar nga zyra e Gysit për t'u bërë deputete?!

12:07 : 24/09/2026



Pritet t'i komunikohet masa, Vlorë Hyseni mbërrin në GJKKO

11:58 : 24/09/2026



“PS Parti e Skandaleve, jo më Parti Socialiste”/ Zhupa: Vlorë Hyseni simbol i tradhtisë kombëtare!


11:40 : 24/09/2026



Zbardhet atentati ndaj vëllait të Fabio Dushkut në Greqi, arrestohen 3 shqiptarë /EMRAT

11:39 : 24/09/2026

OM





Në foto: Ish-shefja e SHISH, Viora Hyseni

Opozita, e cila e ka akuzuar publikisht Viora Hysenin prej kohësh se ka shpërndarë informacione sekrete për grupe kriminale, ka deklaruar këto ditë se Prokuroria e Posaçme shpërndan qëllimisht informacione “rozë”, për të shmangur skandalet e vërteta të kryera nga ish-drejtuësja e SHISH.

Më herët, Prokuroria e Posaçme zhvilloi një hetim ndaj ish-zv.kryeministrit Arben Ahmetaj, për “afërën e inceneratorëve”. Të dhënat e përcjella fillimisht nga dosja hetimore u fokusuan kryesisht tek “lodra seksi”, të gjetura në një nga ambientet e dyshuara si në pronësi të Ahmetajt.



Në foto: Ish-zv.kryeministri, Arben Ahmetaj

Ish-numri dy i qeverisë ka mohuar çdo firmë për “afërën e inceneratorëve”, duke ia ngarkuar përgjegjësinë ish-shefit të tij, kryeministrit Edi Rama.

Në dalje publike, Ahmetaj është shprehur i bindur se nxjerrja e detajeve të “lodrave të seksit” ka qenë një “operacion ndikimi”, një fushatë delegjitimi të personit të tij nga SPAK-u, me qëllim për të fshehur dhe anashkaluar përgjegjësitë e Ramës në skandalin e inceneratorëve.

Kur Prokuroria e Posaçme arrestoi kryetarin e Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj, për korrupsion, u kujdes të shpërndante publikisht faktin se bashkëshortja e tij, Ajola Xoxe, kishte blerë rreth 860 mijë euro veshje të brendshme, mbathje e të tjera intime.

Xoxe dhe avokatët e Veliaj kanë deklaruar se këto shpenzime nuk janë personale, por për veprat artistike që kuronte zonja e kryebashkiakut, në aktivitetet e organizuara nga një grup organizatash jo-qeveritare.





Në foto: Kryebashkiaku i arrestuar i Tiranës, Erion Veliaj

Narrative e ngritur nga SPAK-u për veshjet intime zuri vend gjerësisht në publik, duke mbuluar dyshimet e ngritura, kryesisht nga opozita, se prokurorët po shmangin problemet e vërteta të Veliajt me korrupsionin, për çështje që lidhen me inceneratorin e Tiranës apo me korrupsionin e dyshuar masiv me lejet e ndërtimit në kryeqytet.

Tre rastet, ndër më tipiket e ngritura nga Prokuroria e Posaçme, përmbajnë element të asaj që Byroja Federale e Investigimit në Shtetet e Bashkuara, FBI-ja, e quan me termin *“operacion ndikimi”*.

Është një strategji, e cila duket se po zbatohet me përpikmëri nga SPAK-u-shpërndarja e *“kronikës rozë”*, me qëllim shmangien nga problemet e vërteta.

“Operacion ndikimi”

Një *“operacion ndikimi”*, në mënyrë të përmbledhur, është një veprimtari e organizuar që synon të ndryshojë mënyrën se si një person, grup ose publiku e percepton një objektiv.

Qëllimi nuk është domosdoshmërisht të shpikësh një gënjeshtër. Mund të përdorësh fakte të vërteta, por të vendosësh cilat fakte dalin në publik, kur dalin, si paraqiten dhe sa shumë përsëriten.

Le të marrim një situatë hipotetike. Një aktor publik, përshembull SPAK-u, ka interes që publiku të krijojë një imazh të caktuar për një individ.

Nuk ka nevojë të shpikësh asgjë. Por, mund të ndjekësh një strategji të tillë: përzgjedh 2-3 nga një mori episodesh negative. I nxjerr në media të caktuara, jep informacion të pjesshëm, pa dhënë të gjithë kontekstin. Të njëjtën histori e shpërndan *“me pikatore”* për shumë ditë, në kanale të ndryshme mediatike.

Në foto: Prezantim grafik i një *“operacioni ndikimi”*

Në fund, publiku ekspozohet vazhdimisht ndaj të njëjtave fakte. Dhe, ja ku jemi: hetimi për aferën e inceneratorëve ndaj Ahmetajt, përfundoi tek *“lodrat seksi”*. Hetimi për Veliajn u kanalizuar tek *“mbathjet e Ajolës”*, ndërsa ai për Vlora Hysenin, mbetet tek mesazhet e dashurisë së saj ndaj Agasit.

Pra, qëllimi nuk është domosdoshmërisht të shpikësh një gënjeshtër. Mund të përdorësh fakte të vërteta, por të vendosësh cilat fakte dalin në publik, kur dalin, si paraqiten dhe sa shumë përsëriten.

Pse duhet *“kronika rozë”*

Në një shoqëri globale, e cila prirret më shumë nga *“histori telenovelash”*, përfshirja e elementëve rozë në hetimet penale përbën gjithnjë një interes të shtuar. Prokurorët e posaçëm shqiptarë nuk kanë *“shpikur rotën”* në këtë drejtim.

Shumë agjenci ndërkombëtare, sidomos atë që lidhen me Inteligjencën, i shfrytëzojnë elementët rozë, me qëllim për të shmangur vëmendjen e opinionit nga thelbi real i problemit, i krimit të supozuar dhe shmangia e bashkëpunëtorëve apo zyrtarëve më të rëndësishëm se sa subjektet e hetimit.

Studimet mbi raportimin e krimit tregojnë se media i japin disproporcionalisht më shumë vëmendje rasteve spektakolare dhe sensacionale, ndërsa raportimi i krimit në përgjithësi nuk

pasqyron domosdoshmërisht shpërndarjen reale të kriminalitetit.

Jeta private, marrëdhëniet intime, kanë një tërheqje më të madhe për publikin. Çështjet penale janë komplekse (kontrata, dokumenti, procedura, etj). Ndërsa elementët intimë e bëjnë më të thjeshtë (zyrtari, burri, gruaja, i/e dashura, sekret).

Por për zyrtarët e lartë ekziston edhe diçka tjetër: zhvendosja e fokusit. Pyetja kryesore në një hetim penal ndaj zyrtarëve: çfarë kanë bërë?

Por, duke përfshirë “elementin rozë”, e gjithë vëmendja shkon tek elementë, si: *me kë ka pasur lidhje, ku ka fjetur, mesazhet private, jeta seksuale, fotografitë dhe videot personale.*

Media, natyrisht, i përtyp menjëherë lajmet sensacionale. Por, kur ato janë të vetmet informacione që trafikohen nga dosjet sekrete të Prokurorisë së Posaçme, atëherë gjithçka duket se është një “operacion ndikimi”.

Etiketa: Operacion ndikimi spak vlora hyseni

Lajme të lidhura



VIDEO/ Viora Hyseni shantazhon publikisht gazetaren Klodiana Lala

12:31 : 24/09/2026



Pritet t'i komunikohet masa, Viora Hyseni mbërrin në GJKKO

11:58 : 24/09/2026



“PS Parti e Skandaleve, jo më Parti Socialiste”/ Zhupa: Viora Hyseni simbol i tradhtisë kombëtare!

11:40 : 24/09/2026



SPAK thotë se ka fshirë kamerat e sigurisë për takimet e Agasit/ Embro Sulejmanit: I kam çuar vetëm supë...

11:27 : 24/09/2026



Hetimet për Agasin/ GJKKO lë në burg Embro Sulejmanin dhe Fatjon Kallucin

11:05 : 24/09/2026



Berisha: Viora Hyseni shërbëtore e Vuçitit dhe ushtarë e Agasit! Është shembur siguria kombëtare

10:46 : 24/09/2026

mediatik.
Na kontakto:

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.